

FJALA E DEPUTETIT ENKELEJD ALIBEAJ

E ENJTE 23 QERSHOR 2022

Rregullorja është akti i cili mban në këmbë veprimtarinë e këtij parlamenti. Fakti që ju keni përfshirë në rendin e ditës një akt normativ ende pa u marrë mendimi i njërit prej komisioneve, e bën të detyrueshme të mos përfshihet në rendin e ditës së sotme. Kështu që, jemi dakord që kjo pikë e rendit të ditës duhet të shtyhet, sepse të gjitha komisionet kanë të drejtën të japin mendimin e tyre dhe kjo nuk është fakultative.

E dyta, se kur do të diskutohet nuk mund të jetë një çështje që e përcakton kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, kjo është kompetencë e Kryetarit të Kuvendit apo e Konferencës së Kryetarëve, në rastin më të mirë. Kështu që, arsyetimi që kjo çështje duhet të shtyhet me një javë për arsye se nuk ka ardhur një opinion nga komisioni për dhënie mendimi, nuk qëndron, sepse qeveria e ka pasur detyrim ta paraqiste vetë aktin normativ në parlament që në momentin kur e ka miratuar. Është bërë praktikë e këtij parlamenti dhe e qeverisë të miratojë gjithmonë e më tepër akte normative, duke i hequr të drejtën legislative parlamentit, pa asnjë kusht dhe pa asnjë kriter, dhe jo vetëm kaq, por i sjell në momentin e fundit.

Dihet që akti normativ ka një afat 45 - ditor, kohë e mjaftueshme për qeverinë ta paraqesë në parlament dhe për ta diskutuar në komisionet përkatëse. Pse qeveria e sjell me vonesë, kjo nuk është arsye apo shkak që do të duhet domosdoshmërisht të shtyhet, siç propozon kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste. Për pjesën e shtyrjes, po, Rregullorja kërkon të merren të gjitha mendimet e komisioneve përkatëse dhe pastaj është e drejta dhe kompetenca juaj ta përcaktoni këtu. Kur ta përcaktoni ju, në Konferencën e Kryetarëve apo jo, do të themi edhe ne fjalën tonë. Pra, për pjesën e parë jemi dakord, duhet të shtyhet dhe të mos diskutohet sot. Faleminderit!